

VENDIM
Nr. 530, datë 25.9.2025

PËR SHKËMBIMIN E PRONËS ME EMËRTIMIN “NJËSIA E SIGURISË PUBLIKE SHKODËR”, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, ME PASURINË NR. 19/10, NË ZONËN KADASTRALE 3168, SHKODËR, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëmbimin e pronës me emërtimin “Njësia e sigurisë publike Shkodër”, me sipërfaqe truall 25 590 (njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) m², dhe sipërfaqe ndërtimore 1 286 m² (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) m², në zonën kadastrale 8592, Shkodër, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas formularit të përditësimit dhe planit të rilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, me pasurinë nr. 19/10, zona kadastrale 3168, Shkodër, me sipërfaqe 23 149 (njëzet e tre mijë e njëqind e dyzet e nëntë) m², në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar, hiqet prona me emërtimin “Njësia e sigurisë publike Shkodër” dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, me qëllim ushtrimin e funksioneve social-kulturore dhe sportive.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, hiqet pasuria nr. 19/10, në zonën kadastrale 3168, dhe i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar, me qëllim ushtrimin e funksioneve të rendit dhe sigurisë publike.

4. Shkëmbimi i këtyre pronave kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e tyre.

5. Shkëmbimi realizohet nëpërmjet kontratës së shkëmbimit, e cila lidhet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Shkodër, pasi të jetë bërë akomodimi i përshtatshëm i “Njesisë së sigurisë publike Shkodër” dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për ushtrimin e funksioneve administrative të kësaj njësie.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET

DATË 01.09.2025


QËLLIMI: TRANSFERIM

VENDNDODHJA: BASHKIA SHKODËR DVASHKIZVASHK SHKODËR ZONA KADASTRALE: 8592 NUMRI PASURISË: 10/241; 10/128; 10/129; 10/130; 10/131; 10/132; 10/133; 10/134 INDEX HARTE: SH; H-9,10; I-10
TË DHËNA TË PASURISË:
LLOJI PASURISË: TRUALL SIP. TRUALL: 25590.63 m² SIPËRFAQJA GJURMËS NDËRTIMIT TË OBJEKTIT: 1229.35 m² NUMRI KATEVE: NUMRI PEMËVE

X,Y 480187.535
480220.723

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE


481113.335
480220.723 X,Y



X,Y 480187.535
480220.723

SHKALLA 1:2500

481113.335
480220.723 X,Y



 KUFIRI I PRONËS SIPAS FAKTIT

 GJURMË NDËRTIMI

SHPJEGUES

SIPËRFAQJA TOTALE E TRUALLIT 25 590 M2

SIPËRFAQJE TOTALE NDËRTESASH 1 286 M2

N1 - SIPËRFAQJA 348 M2

N2 - SIPËRFAQJA 216 M2

N3 - SIPËRFAQJA 63 M2

N4 - SIPËRFAQJA 19 M2

N5 - SIPËRFAQJA 240 M2

N6 - SIPËRFAQJA 64 M2

N7 - SIPËRFAQJA 336 M2

 NDËRTESA E PAS. 10/132, RRËNOJË E PAPËRFSHIRË
NË PËRDITËSIMIN E VKM. (nr. rendor 8 te formulari i VKM 840/2015)

FOTOGRAFIMI SATELITOR

NR.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARËT	ID/NIPT	SHENIME TË REALIZUESIT
1	VERI			10/25; 10/21;		
2	LINDJE			10/25;		
3	JUG			10/10; 10/12;		
4	PËRËNDIM			10/124; 10/125;		

DREJTORIA ASETVE E KADASTRES URBANE

SPECIALISTI: ARJAN VASJIA

REALIZOI PËR ASHK

SPECIALISTI:

NËNSHKRIMI

KONFIRMOI: DREJTOR/PËRGJEGJËS

NËNSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologji e matjeve T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitare te Gjithe; KP-Kufitare Pjeserisht;

PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT:

MINISTRIA E BRENDSHME

PERFAQESUESI I INSTITUCIONIT QENDROR: ABASHKIA SHKODER

ZV/KRYTARI
ALBAN PREKA

Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitare te Gjithe; KP-Kufitare Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën: Arjan VASIJA Arban GJOKA Specialist (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Supërvizori: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Aprobimi: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula) Zv. Kryetar me vendim delegimi												
Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga Sip. Truallit (m ²)	Nga Sip. Ndertësë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronat/ pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
	8592	10/241 10/128 10/130 10/131 10/132 10/133 10/134	Truall	Hapësire Rekreacioni	25590	25590	1286	Social Kulturore Sportive	Bashkia Shkoder	Bashkia Shkoder		
			N1				348	Godina e Komandes				
			N2				216	Fjetore				
			N3				63	Tualet				
			N4				19	Oti/Roje				
			N5				240	Park Automjetesh				
			N6				64	Oficinë				
			N7				336	Mensa				
			Totali Truall + ndertese		25590	25590	1286					

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për pronat me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3168006134
(Nga 3168001146, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3168, Lloji i Pasurisë: SHESH, Nr. i Pasurisë: 19/10, Sipërfaqja Totale 23149 m²,
(Nga të Cilat Truall 1176.55 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-64-210-B, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia RRENC, Rruga RRENC, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 4332, Dt. 05/03/2025), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA SHKODER, Nr. Identifikimi/NIPT K36813001H, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia SHKODER, Rruga 13 DHJETORI, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 4332, Datë: 05/03/2025

Regjistruar: Nr. 737, Datë: 05/04/2025

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. __, me Kod Unik __*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: __, Nr. __, Datë: __

Përshkrimi i Objektit të Aktit: __

Regjistruar: Nr. __, Datë: __



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00000579	18/01/2024	Përdorim	VKM për të drejtën e administrimit/pë rdorimit	274	02/05/2019	20 vite	Drejtoria Përgjithshme e Rezervave Mat.të Shtetit	J72415001A

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi Nr. 274,
Datë: 02/05/2019

Regjistruar: Nr. 0579, Datë: 12/07/2021

Përshkrimi: Sipërfaqja e gjurmeve të ndërtimit është 2353.1m2 (Objektet e Rrenuara)

DREJTORI
Eglantina Frroku

Data e lëshimit 17/09/2025



Shënim: Ky dokument është gëneruar dhe vëlosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE : 3168006134

KODI UNIK : 3168006134

PASURISË : 19 / 10

INDEX I HARTËS :

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: ~~2500~~

DREJTORI



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vëloset me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDERTESA